



Republika e Maqedonisë së Veriut
Qendra Shtetërore e Provimeve

KONCEPTI PËR TESTIM SHKETËROR NË ARSIMIN FILLOR



Shkup, viti 2020

Botuesi: **Qendra Shtetërore e Provimeve**



KONCEPTI PËR TESTIM SHTETËROR në arsimin fillor

Koncepti për testimin shtetëror në arsimin fillor u miratua nga ministri i Arsimit dhe Shkencës, me Vendimin nr. 18-5737 / 1 më datë 12.06.2020.

**Autorë: Mr. Billjana Mihajlovska
Dr. Beti Llameva**

Grupi punues për përpilimin e Konceptit për testimin shtetëror në arsimin fillor si dhe për dokumentin e Pozicionit për testimin shtetëror:

Mr. Billjana Mihajlovska, kryetar, Qendra Shtetërore e Provimeve
Dr. Beti Llameva, anëtar, Qendra Shtetërore e Provimeve
Mr. Tanja Andonova - Mitrevska, anëtar, Qendra Shtetërore e Provimeve
Mr. Gordana Trajkova - Kostovska, anëtar, Qendra Shtetërore e Provimeve
Afërdita Saraçini, anëtar, Qendra Shtetërore e Provimeve
Sanja Josifovska, anëtar, Qendra Shtetërore e Provimeve
Elena Ivanovska, anëtar, Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Verica Zllatanska - Paunovska, anëtar, Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Mr. Liljana Polenakoviç, anëtar, Byroja për Zhvillimin e Arsimit
Mr. Ivanka Mijiç, MA, anëtar, Byroja për Zhvillimin e Arsimit
Leposava Dohçeva, anëtar, Shkolla fillore "Aco Shopov"
Julijana Todorovska, anëtar, Shkolla fillore "Dimitar Makedonski"

CIP - Каталогизација во публикација

Falënderim

Autorët falënderojnë të gjithë bashkëpunëtorët, dhe veçanërisht *George Bethell*, Specialist për Vlerësimin në Arsim dhe Drejtor i Anglia Assessment, dhe *Mr. Bojana Naceva*, Specialiste për Arsim në Bankën Botërore në RMV, për ndihmën dhe përkrahjen e tyre të sinqertë gjatë hartimit të *Konceptit për testimin shtetëror si dhe Dokumentin e Pozicionit për testimin shtetëror.*

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	5
2. SHPJEGIMI I TERMEVE	7
3. ARSYETIME	9
4. KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME TË VLERËSIMEVE	
ME PËRMASA TË MËDHA	11
5. VLERËSIMI SHTETËRORË PËRBALL STUDIMEVE NDËRKOMBËTARE	13
6. QËLLIMI I TESTIMIT SHTETËROR	15
7. PARAMETRAT KRYESORE (KYÇE) TË DIZAJNIT	17
7.1. Popullata qëllimore	17
7.2. Grupet qëllimore (target)	17
7.3. Shembull	17
7.4. Lëndët mësimore	18
7.5. Dinamika (frekuenca) e vlerësimit	19
7.6. Metodatat e lajmërimit të rezultateve	19
8. REALIZIMI I TESTIMIT SHTETËROR	21
8.1. 8.1. Administrimi i përgjithshëm	21
8.2. Testet	21
8.3. Pyetësorët	22
8.4. Vlerësimi (kodimi) i përgjigjeve të nxënësve	23
8.5. Regjistrimi, përpunimi dhe analiza e të dhënave	23
9. PUBLIKIMI I REZULTATEVE DHE SHPËRNDARJA	25
9.1. Raportet	25
9.2. Tribunat	26
9.3. Trajnimet	26
9.4. Qasje elektronike tek rezultatet	26
9.5. Materiale profesionale për mësimdhënësit	27
9.6. "Ajtem banka" elektronike	27
10. PËRGJEGJËSIA INSTITUCIONALE	29
10.1. Ministria e arsimit dhe shkencës	29
10.2. Qendra shtetërore e provimeve	29
10.3. Shkollat fillore publike	30
11. KORNIZA KOHORE PËR REALIZIMIN	31
12. PËRFUNDIME	33
SHTOJCË	35



TESTIM
SHTETËROR

1 HYRJE

Përmirësimi i cilësisë dhe rritja e efikasitetit në arsim, në përputhje me standardet moderne arsimore në botë, janë qëllimet kryesore të politikës arsimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMV). Për të arritur këto qëllime, veçanërisht në arsimin fillor, Qeveria e RMV, përmes Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH), duhet të zhvillojë dhe të realizojë një testim gjithëpërfshirës shtetëror (TSH) i cili do të monitorojë sistematikisht arritjet e nxënësve, dhe me këtë edhe arritjet arsimore në përgjithësi. Testimi i tillë shtetëror do të sigurojë një vlerësim të efektivitetit të sistemit aktual arsimor dhe do të jetë bazë për përmirësimin e mëtejshëm cilësor të tij.

Ky dokument përcakton Konceptin që do të mbështesë testimin shtetëror. Në te përshkruhen qëllimet e testimit shtetëror, parimet udhëheqëse sipas të cilave do të funksionojë si dhe metodat e përgjithshme që do të përdoren gjatë realizimit të studimeve që janë pjesë e testimit shtetëror.

Koncepti është zhvilluar nga një Grup pune profesional i formuar nga Drejtori i Qendrës Shtetërore të Provimeve (QSHP). Detajet e plota të diskutimeve teknike, nga të cilat dolën vendimet në lidhje me testimin shtetëror të vendosura në këtë Koncept, janë dhënë në "Dokumenti pozicionues për testimin shtetëror"¹, në të cilin janë marr parasysh praktikatat më të mira ndërkombëtare dhe konteksti mbizotërues në RMV.

Testimi shtetëror është një segment i rëndësishëm i planeve strategjike të zhvillimit të arsimit në RMV, i cili duhet të kontribuojë në implementimin e tyre të suksesshëm. Prandaj, testimi shtetëror është i integruar në Ligjin për arsimin fillor, me çka është shprehur qëllimi serioz i Qeverisë së RMV për realizimin konsekuent të tij. Ligji për arsimin fillor² e përcakton kornizën ligjore për inkuadrimin e testimit shtetëror dhe delegon përgjegjësinë për dizajnimin dhe realizimin e tij.

Gjithashtu, testimi shtetëror bazohet në dokumente të shumta strategjike të përpiluara gjatë viteve të fundit, mes të cilave edhe:

¹ "Dokumenti i pozicionit për testimin e shtetëror" është përgatitur në vitin 2020 nga Grupi i Punës për përgatitjen e Konceptit për testimin shtetëror. Grupi i Punës, i formuar nga drejtori i Qendrës Shtetërore të Provimeve, përfshin anëtarë nga Qendra Shtetërore e Provimeve, Ministria e Arsimit, Byroja për Zhvillimin e Arsimit dhe praktikuesit e arsimit fillor.

² Ligji për arsimin fillor, Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 161 nga 05.08.2019.

- Strategjia e arsimit për vitin 2018 - 2025;
- Koncepti për arsimin fillor nëntëvjeçar dhe edukimin;
- Programi Nacional për Zhvillimin e Arsimit në Republikën e Maqedonisë 2005 - 2015.

Kjo reformë e rëndësishme në arsimin fillor në RMV është në përputhje me rekomandimet e OECD të përcaktuara në dokumentin "Pasqyrë e OECD për evalvimin dhe vlerësimin në arsim në Republikën e Maqedonisë së Veriut"³ dhe do të realizohet në kuadër të "Projektit për avancimin e arsimit fillor", të propozuar nga Qeveria e RMV dhe mbështetur nga Banka Botërore.


³ OECD (2019), *OECD Reviews of Evaluation and Assessment in Education: North Macedonia*, OECD Reviews of Evaluation and Assessment in Education, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/079fe34c-en>.

2 SHPJEGIMI I TERMEVE

Në këtë dokument, shprehet teknike të cekura më poshtë përdoren me kuptimet vijuese:

- **Vlerësim (vlerësimi i arsimit):** Termi i përgjithshëm që zbatohet për të gjitha aktivitetet e realizuara në ambient arsimor që të përcaktohet statusi i të nxënësve për çfarëdo qëllimi. Që këtu, termi përfshin gjithçka - nga vlerësimi joformal i nxënësve në klasë nga ana e mësimit nënësve për qëllime diagnostikuese, e deri te vlerësimet formale, siç është matura, e cila përdoret për seleksionim në një mjedis konkurrues.
- **Provime:** Vlerësime formale të arritjeve të nxënësve, zakonisht të realizuara në kushte rreptësisht të kontrolluara, të cilat përdoren për certifikimin e arritjeve të nxënësve dhe/ose për seleksionimin e nxënësve për fazat e mëtutjeshme të arsimit (p.sh., provimet e maturës shtetërore në RMV).
- **Vlerësim me përmasa të mëdha:** Studim për vlerësim në të cilin marrin pjesë ose përfaqësohen me mostër një numër shumë i madh nxënësish. Termi përgjithësisht i referohet vlerësimeve ndërkombëtare dhe testim shtetërore (vlerësime nacionale).
- **Vlerësim ndërkombëtar:** Studim për vlerësim në përmasa të mëdha në të cilin marrin pjesë një numër i madh vendesh. Një nga qëllimet e studimeve të këtilla është të sigurojë të dhëna që mund të përdoren për të bërë krahasime ndërkombëtare lidhur me arritjet e nxënësve (p.sh. TIMSS, PIRLS, dhe PISA⁴).
- **Testim shtetëror:** Një seri gjithëpërfshirëse e testeve shtetërore (studimeve) që realizohen në kontinuitet. Në testimin shtetëror specifikohen natyra dhe frekuentimi i studimeve që duhet realizuar me kalimin e kohës për të gjitha grupet qëllimore (klasa) dhe për të gjitha fushat arsimore (lëndët mësimore).
- **Testim shtetëror (studimi):** Studim specifik i caktuar i realizuar si pjesë e procesit të përgjithshëm të testimit shtetëror (p.sh., "Testimi shtetëror i arritjeve të nxënësve të klasës së pestë në matematikë dhe gjuhë amtare të realizuar në vitin 2024").

⁴ Studimi Ndërkombëtar i Prirjeve (trendeve) në mësimin e Matematikës dhe Shkencave të Natyrës (TIMSS); Studimi ndërkombëtar për avancimin e lexim-kuptimit në arsimin fillor (PIRLS); Programi Ndërkombëtar i Vlerësimit të Nxënësve (PISA).



3 ARSYETIMI

Në përgjithësi pranohet që vlerësimi është një elementi kryesor në procesin arsimor. Vlerësimi tradicionalisht bën matjen dhe evidenton arritjet individuale të nxënësve, por, gjithashtu, mund të sigurojë informacione që mund të përdoren në politikat dhe praktikatat reformuese që të përmirësohet efektiviteti dhe efikasiteti i sistemit arsimor. Korniza "Qasja sistematike për rezultate më të mira arsimore" e Bankës Botërore – SABER⁵ identifikon katër kategori vlerësimi që janë pjesë e sistemeve arsimore cilësore, përkatësisht:

■ Vlerësimi në klasë:

Vlerësimet e bëra nga mësuesit për qëllime diagnostikuese dhe për përcjelljen dhe evidentimin e arritjeve të nxënësve.

⁵ Më shumë informacione rreth SABER mund të gjeni në <http://saber.worldbank.org/>.

■ Provime:

Vlerësimet formale që zakonisht bëhen nën kushte të kontrolluara për të certifikuar arritjet e nxënësve dhe/ose për të bërë seleksionimin e nxënësve për fazat e mëtejshme të arsimit.

■ Vlerësime ndërkombëtare në përmasa të mëdha:

Vlerësime të organizuara nga organizata ndërkombëtare të cilat në mënyrë sistematike matin arritjet e nxënësve në vendet - pjesëmarrëse, që mundëson të bëhen krahasime ndërkombëtare.

■ Testim shtetëror (vlerësime nacionale) në përmasa të mëdha:

Vlerësime të dizajnuara dhe të realizuara nga një vend me qëllim matjen sistematike të arritjeve të nxënësve, që mundëson evalvim në nivel sistematik dhe sigurimin e informacioneve që mund të përdoren për të formësuar politikatat dhe praktikatat arsimore.

Tri të parat nga këto forma të vlerësimit tashmë janë të inkuadruara në sistemin arsimor të RMV.

1. Të gjithë mësuesit vlerësojnë rregullisht përpunimin e nxënësve të tyre përmes metodave formale dhe joformale dhe për rezultatet i njoftojnë prindërit dhe palët e tjera të interesuara përmes një sistemi të njohur dhe të besueshëm raportimi.

2. Nxënësit që kryejnë shkollën e mesme i nënshtrihen provimeve të maturës shtetërore, rezultatet e të cilave përdoren për të konfirmuar arritjet e tyre dhe në procesin e seleksionimit në institucionet e arsimit të lartë. Provimet e maturës shtetërore të cilat i realizon Qendra Shtetërore e Provimeve (QSHP) japin rezultate të besueshme që shoqëria i pranon si të vërteta.
3. RMV me vite merr pjesë në të gjitha studimet më të mëdha ndërkombëtare për matjen e arritjeve të nxënësve: në TIMSS nga viti 1999, në PIRLS nga viti 2001 dhe në PISA nga viti 2000.

Forma e vetme e vlerësimit që nuk është ende një karakteristike e rregullt dhe e përhershme e sistemit tonë arsimor është testimi shtetëror (vlerësimi nacional) në përmasa të mëdha. Pikërisht ky *Koncept për testimin shtetëror* është një shprehje e përkushtimit të Qeverisë së RMV dhe MASH për të ndryshuar këtë situatë në arsim.

Testimi shtetëror në përmasa të mëdha, që përshkruhet në këtë *Koncept*, është plotësisht në përputhje me strategjinë e Qeverisë dhe është rregulluar me Ligjin për arsimin fillor.

4

KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME TE VLERËSIMEVE NË PËRMASA TE MËDHA

Vlerësimet (testet) me përmasa të mëdha - shtetërore dhe ndërkombëtare - kanë tipare të veçanta sipas të cilave dallojnë nga sistemet tradicionale të provimeve. Dallimi më i rëndësishëm është se provimet tradicionale përqendrohen në arritjet e nxënësve individualisht, ndërsa, vlerësimet me përmasa të mëdha kryesisht i referohen mbledhjes së informacioneve mbi arritjet tipike në nivel sistemi, d.m.th. për të gjithë nxënësit së bashku dhe/ose vetëm për nëngrupe të definuar konkretisht. Për ta arritur këtë, vlerësimet me përmasa të mëdha kanë këto karakteristika të përgjithshme:

- Bazohen në pyetje kërkimore të caktuara paraprakisht si: "A kanë djemtë dhe vajzat rezultate të ngjashme?", "A ndryshojnë rezultatet e nxënësve të mjediseve urbane nga rezultatet e nxënësve të mjediseve rurale?", "A kanë rezultate të njëjta nxënësit të cilëve u ligjërojnë mësues rishtas të punë-

suar me ata të cilëve u ligjërojnë mësues me më shumë përvojë?" dhe të ngjashme. *Pyetjet hulumtuese të caktuara paraprakisht përcaktojnë cilat të dhëna do të mblidhen dhe si ato do të analizohen, prezantohen dhe përdoren.*

- Mbledhin të dhëna për faktorët në prapavijë, për të cilat supozohet se ndikojnë ndaj arritjeve të nxënësve. Të dhënat kontekstuale mblidhen përmes pyetësorëve që plotësohen gjatë testimit të nxënësve. *Pyetjet hulumtuese përcaktojnë se cilat të dhëna nga sfondi do të mblidhen nga nxënësit, mësuesit, drejtorët e shkollave, etj.*
- Mbledhin të dhëna për arritjet e nxënësve përmes testimit. Procesi i testimit brenda vlerësimeve me përmasa të mëdha mund të duket si realizim provimi, por ka dallime të rëndësishme. Për shembull, nxënësve në të njëjtën klasë mund t'u jepen teste të ndryshme për t'i zgjidhur. Kjo është me qëllim që të sigurohen të dhëna të mjaftueshme për të gjitha qëllimet dhe rezultatet nga mësimi të cilat janë të përfshira në dizajnin e kornizës për vlerësim.
- Qëllimet e tyre mund të arrihen duke testuar një kampion përfaqësues të nxënësve sesa të gjithë grupin. Nivelet e arritjeve të nxënësve në kampion mund të gjeneralizohen për tërë popullatën. *Vlerësimet e bazuara në kampion ofrojnë një mënyrë më efikase për mbledhjen e të dhënave sesa vlerësimet në të cilat testohen të gjithë nxënësit.*

- Përdorin procedura teknike të sofistikuara me qëllim që të sigurohet që të dhënat e mbledhura janë gjithëpërfshirëse, të besueshme, vërtetë dhe mjaft të sakta. Për shembull, procedurat e sofistikuara të pikëve të testimit përdoren për të lidhur rezultatet e nxënësve nga testet e ndryshme dhe, me kalimin e kohës, për të standardizuar matjet. Po ashtu, përdoren teknika statistikore të sofistikuara me qëllim që të gjenerohen nivele të sakta shtetërore (nacionale) të arritjeve, në bazë të rezultateve që kanë arritur nxënësit nga një kampion reprezentues.
- Përdorin një numër të madh metodash për transmetimin e gjetjeve kyçe tek palët e përfshira, me qëllim që ata të ndërmarrin aktivitete për të përmirësuar rezultatet. *Qëllimi kryesor i vlerësimit me përmasa të mëdha është të gjenerohen të dhëna dhe informacione të besueshme që mund të përdoren për përmirësimin e rezultateve të ardhshme nga mësimi. Kjo zakonisht nënkupton bërjen e më shumë raporteve, secili i drejtuar një audience kryesore, siç janë hartuesit e politikave arsimore ose praktikuesit (mësuesit, drejtorët e shkollave, etj.).*

5

VLERËSIMI SHETËTOR PËRBALLË STUDIMEVE NDËRKOMBETARE

Vlerësimet ndërkombëtare dhe shtetërore ndajnë shumë karakteristika të njëjta. Testimi shtetëror i përshkruar në këtë *Koncept* përfshin praktikën më të mirë nga studimet më të mëdha ndërkombëtare. Megjithatë, ekziston një ndryshim fundamental i cili është me rëndësi kyçe. Me qëllim që të mundësohen krahasime valide mes vendeve, të gjitha vendet që marrin pjesë në studime ndërkombëtare janë dakord që të ndjekin të njëjtat procedurat, të përdorin të njëjtët pyetësorë dhe teste (me disa përjashtime të vogla) dhe rezultatet e tyre t'i paraqesin në shkallët e përcaktuara identike të raportimit. Të gjitha këto aspekte janë definuar nga organizata ndërkombëtare e cila është përgjegjëse për organizimin dhe realizimin e vlerësimit.

Testimet shtetërore nuk kanë kufizime të tilla dhe mund të dizajnohen ashtu që në mënyrë më adekuate do t'i përfshijnë prioritetet shtetërore në arsim dhe të përshtaten në kontekstin shtetë-

ror. Për shembull, kornizat e vlerësimit dhe testet për testimin shtetëror në arsimin fillor në RMV do të dalin nga programet mësimore të miratuara nga MASH. Më e rëndësishme është se nivelet e arritjeve që do të përdoren për raportim njëkohësisht do të pasqyrojnë qëllimet arsimore të përfshira në programet mësimore dhe situatën reale në mësim.

Përparësi e testeve shtetërore në krahasim me studimet ndërkombëtare është se testimet shtetërore janë më fleksibël. Pasi që janë nën kontrollin e MASH-it, lehtë mund të përshtaten për të përmbushur nevojat e shtetit dhe të ndjekin ndryshimet. Për shembull, në testimin shtetëror gjithmonë mund të shtohet një lëndë mësimore, përkohësisht ose për kohë më të gjatë, në qoftë se MASH konsideron se është një fushë e rëndësishme për të cilën duhet hulumtim më gjithëpërfshirës.

Të rezytojme, testimet ndërkombëtar dhe ato nacionale kanë shumë karakteristika teknike të përbashkëta, por ndryshime funksionale të ndryshme. Testimi shtetëror i përshkruar në këtë *Koncept* do t'i plotësojë studimet ndërkombëtare në të cilat merr pjesë vendi ynë, veçanërisht ato që po realizohen në arsimin fillor - PIRLS dhe TIMSS. Bashkë me vërejtjet e fituara nga PIRLS dhe TIMSS, testimi i ri shtetëror do të sigurojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe të detajuar të arritjeve të nxënësve në arsimin tonë fillor.



TESTIM
SHTETËROR

6 QËLLIMI I TESTIMIT SHETËTOR

Qëllimi kryesor i testimit shtetëror është, duke përdorur procedurat dhe instrumentat e standardizuara, të sigurojë të dhëna objektive dhe të besueshme për realizimin e standardeve të arritjeve të nxënësve në fushat dhe lëndët mësimore me rëndësi të veçantë gjatë arsimit fillor. Të dhënat e këtilla do të sigurojnë dëshmi për zhvillimin dhe avancimin e politikave arsimore në RMV në drejtim të arritjes së standardeve bashkëkohore arsimore botërore.

Të dhënat e fituara nga testimi shtetëror do të përdoren si:

- *Tregues për njohuritë dhe aftësitë e nxënësve* në mësimin klasor dhe lëndor, nga lëndë dhe fusha të caktuara mësimore, në nivel shtetëror. Të dhënat do të përdoren për të vlerësuar arritjet e nxënësve në lidhje me rezultatet e pritura të mësimin të parapara me programet mësimore dhe/ose me standardet për lëndën përkatëse, si dhe për të krijuar pritshmërinë e ardhshme në lidhje me arritjet e nxënësve
- *Bazë empirike për përmirësimin e cilësisë së arsimit*, duke pasur parasysh që arritjet e nxënësve janë treguesi më i rëndësishëm i cilësisë së arsimit. Vlerësimet e situatës aktuale, masat për përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe ndryshimet në politikat arsimore, përgjithësisht, janë dukshëm më të mira nëse bazohen në të dhëna objektive dhe të besueshme.
- *Njohuri mbi faktorët në prapavijë (në kuadër të shkollës, familjes dhe bashkësisë lokale) që ndikojnë në arritjet e nxënësve.* Me anë të testimit shtetëror përmes pyetësorëve të destinuar për subjekte të ndryshme krijohet një bazë solide e të dhënave për faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në arritjet e nxënësve. Të dhëna të këtilla u mundësojnë krijuesve të politikave arsimore të marrin vendime më të mira dhe më të përshtatshme në lidhje me përmirësimin e kushteve të shkollës dhe ngritjen e cilësisë së mësimdhënies.
- *Treguesit për nevojat e mësuesve të mësimin klasor si dhe lëndor për zhvillimin profesional dhe përmirësimin e efek-*

tivitetit. Kjo do të arrihet duke lidhur qëndrimet dhe përvojat e mësuesve me matjet e arritjeve të nxënësve

Është me rëndësi të theksohet se testimi shtetëror nuk mund të ngërthejë të gjithë elementët e procesit kompleks të mësimdhënies dhe nxënies, e as nuk mund të formësojë të gjitha aspektet në procesin e sigurimit të cilësisë në arsimin fillor. Megjithatë, testimi shtetëror i realizuar në mënyrë të rregullt mund të sigurojë prova (dëshmi) të besueshme të cilat mund të ofrojnë udhëzime për ngritjen e cilësisë së arsimit dhe përmirësimin e arritjeve të nxënësve në nivel shtetëror, në nivel lokal dhe shkollor.

Është veçanërisht e rëndësishme të theksohet se të dhënat e fituara nga testimi shtetëror, siç është përshkruar në këtë *Koncept*, do të grumbullohen dhe do të përdoren në nivelin sistematik. Të dhënat nga testimi shtetëror nuk mund dhe nuk do të përdoren nga ndonjë institucion ose autoritet kompetent për ndjekjen e arritjeve të nxënësve të caktuar, për të vlerësuar punën e mësuesve të caktuar ose për të krahasuar arritjet e shkollave të caktuara.

7

PARAMETRAT KRYESOR TË PROJEKTIT

7.1. POPULLATA QËLLIMORE

Popullata qëllimore (e synuar) e testimit shtetëror do të jenë të gjithë nxënësit e rregullt nga shkollat fillore publike që ndjekin mësimin në gjuhën mësimore maqedonase dhe gjuhën mësimore shqipe. Kjo popullatë do të sigurojë informacione të mjaftueshme për qëllimet e cekura të testimit shtetëror.

Në të ardhmen, kur do të sigurohen burime adekuate, me anë të testimit shtetëror mund të përfshihen edhe nxënës që aktualisht formojnë nëngrupe të vogla (<5%) në sistemin arsimor, përkatësisht nxënësit të cilët e ndjekin mësimin në gjuhën mësimore turke, serbe ose boshnjake ose nxënësit që mësojnë në shkolla fillore private.

7.2. GRUPET QËLLIMORE (TË SYNUARA)

Testimi shtetëror fillimisht do të orientohet në dy faza të rëndësishme të arsimit fillor, gjegjësisht

ndaj grupeve qëllimore që janë në ato faza: nxënësit të cilët janë para përfundimit të klasës së tretë dhe nxënësit të cilët janë para përfundimit të klasës së pestë. Kur testimi shtetëror për këto grupe qëllimore të vendoset mirë dhe kur resurset këtë do ta lejojnë, do të shtohet edhe grupi i tretë qëllimor me të cilin do të rumbullakoset sistemi i testimit shtetëror – nxënësit që janë para përfundimit të klasës së nëntë.

Klasa e tretë është zgjedhur sepse shënon fundin e ciklit të parë të arsimit fillor në RMV. Kjo, po ashtu, paraqet fazën më të hershme në të cilën nxënësit mund të testohen duke përdorur instrumente standarde, objektive.

Klasa e pestë është zgjedhur sepse me të po rumbullakohet mësimi klasor dhe është fazë pas së cilës nxënësit fillojnë me një lloj të ndryshëm arsimit, përkatësisht me mësimin lëndor.

Klasa e nëntë është zgjedhur sepse shënon mbarimin e arsimit fillor nëntëvjeçar, fazë pas së cilës nxënësit kalojnë në arsimin e mesëm. Matja e arritjeve të nxënësve në këtë fazë siguron tregues objektiv për efektivitetin e arsimit në shkollat tona fillore.

7.3. MOSTËR

Testimi shtetëror nuk do t'i përfshijë të gjithë nxënësit nga grupi qëllimor, gjegjësisht do të realizohet duke përdorur një kampion reprezentues. Kjo qasje, që përdoret në të gjitha studimet ndërkombëtare, mundëson matje mjaft

tueshëm precize të arritjeve të nxënësve, duke përdorur burime minimale. Madhësia e kampionit varet nga shkalla e precizitetit të duhur për lajmërimin e masës statistikore. Vlerësimi është se në RMV mund të arrihet një kampion përfaqësues adekuat me realizimin e testimit në rreth 100 shkolla fillore publike, d.m.th. rreth 30% e shkollave fillore publike do të ishin të përfshira në testimin kryesor të secilit cikël të testimit shtetëror.

Mostra do të përgatitet duke përdorur metoda standarde statistikore, bazuar në zgjedhjen e rastësishme të shkollave. Kjo do të mundësojë që rezultatet të përgjithësohen në nivel shtetëror, kurse ndarjet administrative do të jenë me një shkallë preciziteti të pranueshëm.

7.4. LËNDËT MËSIMORE

Në përgjithësi pranohet që kompetenca gjuhësore dhe kompetenca matematikore janë fushat (lëmi) më të rëndësishme arsimore sepse ato përfaqësojnë aftësitë kryesore që janë të nevojshme për mësimin gjatë gjithë jetës. Kjo posaçërisht ka të bëjë për vitet e hershme të arsimit të nxënësve. Konfirmimi i kësaj është fakti se në të gjitha studimet ndërkombëtare dhe në testet shtetërore (vlerësimet nacionale) të vendeve të tjera, gjuha amtare dhe matematika janë lëndët themelore (fushat) që vlerësohen. Testimi shtetëror në RMV do të ndjekë këtë praktikë, përkatësisht gjuha amtare dhe matematika do të testohen në të tre klasat qëllimore: klasa e tretë, e pestë dhe e nëntë.

Kornizat për vlerësim me të cilat do të matin arritjet e të nxënësve në gjuhë amtare dhe matematikë do të bazohen në programet mësimore shtetërore për klasat përkatëse. Theksi do të vendoset në matjen e arritjeve që janë të lidhura me qëllimet më të rëndësishme arsimore të përcaktuara në programet mësimore.

Pas stabilizimit të testimit shtetëror kundrejt matjes së kompetencave gjuhësore dhe matematikore, në përputhje me nevojat e politikës arsimore dhe burimeve të disponueshme, do të inkuadrohet dhe testimi i arritjeve të nxënësve në një lëndë të tretë (fushë), në një ose më shumë klasa qëllimore. Vendimin për zgjedhjen e lëndës së tretë e sjell ministri i arsimit dhe shkencës, me propozim të institucioneve arsimore të përfshira në dizajnimin dhe realizimin e testimit shtetëror.

Lënda e tretë mësimore (fusha) mund të jetë:

- lëndë e mësuar në të gjitha klasat qëllimore (p.sh. gjuhë angleze);
- fusha mësimore që mësohen vazhdimisht, dhe janë të shpërndara në lëndë të ndryshme mësimore (p.sh. fusha të përfaqësuara në lëndët e shkencave natyrore dhe biologjisë ose në lëndët mësimore shoqëri, histori dhe arsim qytetar, et.);
- teste interdisiplinare në fusha të tilla si shkencat natyrore ose shkencat shoqërore.

Lënda e tretë mund të përfshihet në testimin shtetëror rregullisht ose vetëm në një cikël, si temë e veçantë hulumtuese. Mundësitë e ceku-

ra në lidhje me lëndën e tretë mësimore tregojnë fleksibilitetin e testimit shtetëror të përshkruar në këtë Koncept.

Arsimi fillor në RMV realizohet në pesë gjuhë mësimore: gjuhën maqedonase, gjuhën shqipe, gjuhën turke, gjuhën serbe dhe gjuhën boshnjake. Pjesa më e madhe (> 95%) e nxënësve në arsimin fillor vijojnë mësimet në gjuhën mësimore maqedonase ose në gjuhën mësimore shqipe. Prandaj, në vitet e para të testimit shtetëror testet do të përgatiten në gjuhën mësimore maqedonase dhe në gjuhën mësimore shqipe. Sipas standardeve të pranuar ndërkombëtare për realizimin e testeve me përmasa të mëdha, përjashtimi i grupeve gjuhësore të vogla nuk do të ndikojë ndjeshëm në matjet qëllimi i së cilave është të përcaktohen nivelet shtetërore të arritjeve.

Në të ardhmen, në qoftë se nevojiten të dhëna plotësuese për arritjet e nxënësve që vijojnë mësimet në gjuhën mësimore turke, serbe ose boshnjake, ato mund të përfshihen me lejen e ministrit të arsimit dhe shkencës.

7.5. DINAMIKA E VLERËSIMIT

Procesi i testimit shtetëror për secilën klasë zgjat tre vjet, përkatësisht:

- në vitin e parë përpunohet modeli i humlmitit dhe para-testohen instrumentat;
- grumbullimi kryesor i të dhënave (testimi kryesor) zhvillohet në vitin e dytë;

- raportimi dhe shpërndarja (diseminimi) e rezultateve zhvillohen në vitin e tretë, përkatësisht pas testimit kryesor.

Megjithatë, proceset për klasë qëllimore të ndryshme mund të përpunohen në një ose më shumë cikle të testimit shtetëror. Si rezultat i përpunjes, megjithëse një cikël i testimit shtetëror zgjat tre vjet, në praktikë testimi kryesor do të organizohet çdo dy vjet. Kjo dinamikë e testimit shtetëror rrit efikasitetin dhe mundëson grumbullimin e vazhdueshëm dhe rrjedhjen e rregullt të informacioneve në MASH si dhe te praktikuesit në shkolla.

Programi i propozuar për testimin shtetëror në shkolla (testimi kryesor) është paraqitur në tabelën më poshtë. Detaje plotësuese për secilën fazë të testimit shtetëror janë dhënë në Shtojcën e këtij dokumenti.

Klasa	Viti i testimit kryesor						
	2022	2024	2026	2028	2030	2032	2034
kl. 3-të	✓		✓		✓		✓
kl. 5-të		✓		✓		✓	
kl. 9-të				✓		✓	

7.6. METODAT E RAPORTIMIT TË REZULTATEVE

Në përpunje me praktikant më të mira ndërkombëtare, testimi shtetëror do të përdor dy mënyra për raportimin e rezultateve të nxënës-

ve: rezultatin (pikët) e standardizuar dhe arritjet sipas niveleve.

Qendra Shtetërore e Provimeve do të përdor teknika të sofistikuar statistikore për të vendosur rezultatet e nxënësve në një shkallë të standardizuar, numerike për raportim, të ngjashme me atë që përdoret në studimet ndërkombëtare siç janë TIMSS dhe PISA. Këto rezultate numerike do të mundësojnë analizë të mëtejshme të thelluar të arritjeve (performancës) së nxënësve. Duke pasur parasysh që shkalla është fikse, krahasimet mund të bëhen me kalimin e kohës, gjë që nga ana tjetër do të jetë tregues i përparimit.

Arritjet e nxënësve, gjithashtu, mund të shikohen në lidhje me kornizën e harmonizuar të "niveleve të arritjeve". Në këtë mënyrë do të sigurohen informacione mbi përqindjen e nxënësve që e arrijnë nivelin bazë (minimumin e pranueshëm) të arritjeve. Nivelet e arritjeve do të definohen si kombinim i vlerësimit të ekspertëve të lëndëve përkatëse mësimore dhe informacioneve numerike të grumbulluara në procesin e testimit.

8

REALIZIMI I TESTIMIT SHTETËROR

8.1. ADMINISTRIMI GJENERAL (I PËRGJITHSHËM)

Testimi shtetëror do të realizohet në shkollat e përzgjedhura fillore publike. Të gjitha procedurat administrative për realizimin e testimit, përfshirë aplikimin e testeve dhe pyetësorëve, do t'i përcaktojnë dhe dokumentojë QSHP-ja. Në kuadër të secilës shkollë të përfshirë në gjedhe (mostër), organizimi i testimit dhe plotësimi i pyetësorëve do të jetë përgjegjësi e ekipit shkollor të përbërë nga drejtori i shkollës, mësuesit dhe bashkëpunëtorët profesionalë. Këshilltarët e QSHP do t'i trajnojnë të gjitha ekipet e shkollave për zbatimin e drejtë të procedurave.

8.2. TESTET

Siç është përshkruar në pikën 7.4., testet për testimin shtetëror do të përgatiten sipas kornizave të detajuara për vlerësim që do të dalin nga programet mësimore shtetërore. Ato do të përmbajnë detyra që matin arrijtjet e nxënës-

ve në lidhje me qëllimet kryesore arsimore. Me qëllim që të sigurohet besueshmëri e rezultateve, secila fushë e zgjedhur do të përfshihet me numër adekuat detyrash (afërsisht 15), kurse përgjigjet për secilën detyrë do të grumbullohen nga të paktën 250 nxënës. Për të arritur këtë, testi për secilën lëndë mësimore do të ketë një dizajn kompleks, gjegjësisht do të përgatiten disa variante të testit, që do të mundësojë të grumbullohet numër maksimal informacionesh me një ngarkesë minimale të secilit nxënës të përfshirë në testim.

Gjatë dizajnit të testeve (kohëzgjatja, numri dhe formati i detyrave) do të merren parasysh niveli i supozuar i zhvillimit dhe moshë e nxënësve. Kjo është posaçërisht e rëndësishme për testimin në klasën e tretë, ku gjatë dizajnit të testeve do të merren parasysh shkathtësitë e kufizuara për lexim dhe shkrim të nxënësve në atë moshë.

Testet për grupet më të mëdhenj me moshë do të përmbajnë detyra me formate të ndryshme, mes të cilave edhe:

- detyra me zgjedhje të shumëfishtë (nxënësi zgjedh përgjigjen e saktë nga disa alternativa të ofruara);
- detyra me përgjigje të shkurtër (nxënësi shkruan përgjigje të shkurtër që përmban një fjalë, numër ose fjali);
- detyra të tipit të hapur / me mbarim të hapur (nxënësi shkruan përgjigje më të gjatë, zgjidh një detyrë me një procedurë të plotë ose shkruan një zgjidhje të gjerë për një detyrë komplekse).

Në fillim të gjitha testet për testimin shtetëror do të jenë të llojit laps-letër, d.m.th. nxënësit do të marrin teste të shtypura dhe përgjigjet e tyre i shkruajnë në to ose në lista të posaçme për përgjigje. Kjo është në përputhje me praktikat aktuale në shkolla dhe harduerin/softuerin që kanë në dispozicion. Po ashtu, me këtë merret parasysh edhe fakti se te nxënësit më të vegjël ka gjasa të mëdha të kenë njohuri të kufizuara për teknologjinë e informacionit. Në të ardhmen, kur do të krijohen kushtet, testimi mund të realizohet në mënyrë elektronike. Kjo do ta rrisë efikasitetin e procesit të testimit dhe vlerësimin, kurse do t'i zvogëlojë shpenzimet. Në drejtim të një zhvillimi të tillë në të ardhmen, Qendra Shtetërore e Provimeve do të zhvillojë dhe pilotojë procedura të caktuara për testimin dhe administrimin elektronik, paralelisht me realizimin e testimit shtetëror, siç është përshkruar në këtë dokument.

8.3. PYETËSORËT

Të dhënat mbi faktorët kontekstual që konsiderohen se ndikojnë drejtpërdrejt ose indirekt ndaj arritjeve të nxënësve do të grumbullohen përmes disa lloje pyetësorësh: për nxënës, për mësimdhënës nxënësit e të cilëve testohen, dhe për drejtorët e shkollave të zgjedhura në gjedhe. Nëse disa të dhëna të rëndësishme nuk mund të grumbullohen përmes këtyre pyetësorëve, mund të kërkohet që edhe prindërit e nxënësve të testuar gjithashtu të plotësojnë një pyetësor të veçantë.

■ **Pyetësorët e nxënësve** ofrojnë informacione mbi qëndrimet e tyre në lidhje me të mësuarit e lëndëve dhe fushave që testohen, vlerësimin e aftësive të tyre të të nxënësve, aktivitetet jashtë mësimore, mbështetjen gjatë mësimin nga anëtarët e familjes, kushtet për të mësuar në shtëpi, moshë dhe gjinia e nxënësve, edukimi i prindërve, etj. Gjatë administrimit të pyetësorëve për nxënësit më të vegjël, veçanërisht ata nga klasa e tretë dhe klasa e pestë, mësuesit do të inkurajohen të sqarojnë pyetjet në mënyrë që nxënësit të mund të përgjigjen në mënyrë adekuate.

■ **Pyetësorët e mësuesve** sigurojnë të dhëna personale (mosha dhe gjinia e mësuesve, përvoja e punës, etj.), të dhëna mbi qëndrimet e tyre lidhur me programet mësimore të përfshira në testimin shtetëror, mënyrën e vlerësimit, mënyrën e punës dhe kushtet në të cilat punojnë, motivimin për punë, zhvillimin profesional, etj.

■ **Pyetësorët për drejtorët e shkollave** ofrojnë informacion mbi madhësinë e shkollës dhe organizimin e saj, kushtet dhe burimet në shkollë, organizimi i mësimin dhe puna e drejtorit, si dhe vlerësimi i klimës shkollore.

Në fillim të testimit shtetëror, pyetësorët do të administrohen në letër, me qëllim që ato të përgatiten edhe në formë elektronike kur do të krijohen kushtet për këtë. QSHP-ja do të sigurojë udhëzime për administrimin e pyetësorëve, në të cilët do të përfshihen informacione se për

çfarë qëllimi do të përdoren të dhënat personale dhe si do të mbrohen.

8.4. VLERËSIMI (KODIMI) I PËRGJIGJEVE TË NXËNËSVE

Për dallim nga provimet, testet shtetërore grumbullojnë të dhëna për numrin e përgjigjeve të sakta, por edhe për përgjigjet e gabuara të dhëna nga nxënësit. Këto të dhëna sigurojnë informacione të vlefshme diagnostikuese për mësuesit dhe praktikuesit e tjerë. Prandaj, QSHP-ja do të hartojë udhëzime për vlerësimin e secilës detyrë dhe për evidentimin e llojeve të ndryshme të përgjigjeve të nxënësve.

Për secilën detyrë me zgjedhje të shumëfish-të, përgjigja e nxënësit - e saktë ose e pasaktë - regjistrohet në bazën e të dhënave. Gjithashtu, kode të veçanta përdoren për të shënuar një pyetje "e anashkaluar" ose një pyetje me një përgjigje të paqartë.

Megjithatë, kodimi i përgjigjeve të nxënësve në detyrat e llojit të hapur kërkon një sistem më të ndërlikuar të kodimit. Udhëzimet për vlerësimin e detyrave të tipit të hapur i harton grupi punues i ekspertëve për lëndën mësimore përkatëse. Ato përbajnë orientime të hollësishme për vlerësimin sa më objektiv të secilës detyrë dhe i përbajnë të gjitha përgjigjet e mundshme të sakta të detyrave me përgjigje të shkurtër dhe të detyrave të llojit të hapur. Në udhëzime, gjithashtu, identifikohen përgjigjet e gabuara tipike, bazuar në keqkuptime të rëndomtë. Grum-

bullimi i të dhënave për kategoritë e ndryshme të përgjigjeve të sakta dhe të pasakta siguron informacione potencialisht të vlefshme.

Për përzgjedhjen e vlerësuesve me kualifikim adekuat, trajnimin e tyre dhe ndjekjen e cilësisë së punës së tyre përgjegjës do të jetë QSHP-ja.

8.5. REGJISTRIMI, PËRPUNIMI DHE ANALIZIMI I TË DHËNAVE

QSHP-ja do të jetë përgjegjëse për vendosjen dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave që do të përdoret për të regjistruar, përpunuar dhe analizuar të dhënat nga çdo studim i testimit shtetëror. QSHP-ja do të trajnojë vlerësuesit dhe personat të cilët do t'i kodojnë informacionet e fituara nga testet e nxënësve dhe nga të gjithë pyetësorët. Të dhënat e fituara do të regjistrohen në bazat e të dhënave, në përputhje me udhëzimet e caktuara teknike. Pas krijimit të kushteve teknike adekuate, do të përdoret njohja automatike e përgjigjeve të nxënësve për pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë. Baza e të dhënave me rezultatet e evidentuara të testimit do të pastrohet nga QSHP-ja me qëllim që të largohen të dhënat e pavlefshme dhe kundëthënëse.

Pasi të kompletohet baza e të dhënave, persona të trajnuar të QSHP-së do t'i përpunojnë të dhënat duke përdorur softuer përkatës për organizimin dhe analizën e të dhënave. Numër i madh i analizave preliminare do të kryhen duke përdorur një softuer standard analitik (p.sh. SPSS ose STATA). Për analizën e mëtutjeshme të për-

gjigjeve të nxënësve për ajtemët e testit dhe llogaritjen e pikëve të standardizuara është e nevojshme të përdoret një softuer më i specializuar psikometrik. Analizat e fituara nga CTT (Classical Test Theory – Teoria klasike e Testit) do të gjenë prova të rëndësishme për cilësinë teknike të ajtemëve dhe do të japin indikacione preliminare për arritjet tipike të nxënësve. Përfundimisht, analizat e fituara nga përdorimi i IRT (Item Response Theory -Teoria e Përgjigjes së Detyrës) do të përdoren për të gjeneruar vlerësime të besueshme, të standardizuara të rezultateve (scor) të secilit nxënës të përfshirë në testim. Prej tyre QSHP-ja do t'i përgjithësojë rezultatet në nivel shtetëror, siç është e parashikuar në objektivat e testimit shtetëror. Prioritet urgjent është forcimi i kapacitetit të QSHP-së për përpunimin e analizave të nevojshme psikometrike, duke përfshirë aplikimin e Teorisë për përgjigje në ajtem (IRT). Do të furnizohet softuer i specializuar dhe njëkohësisht dy ose më shumë punonjës të QSHP-së do të trajnohen për përdorimin e tij dhe aplikimin e IRT.

Pas hartimit të analizave, rezultateve preliminare kuantitative do të përmbliidhen në tabela, diagrame dhe grafikone. QSHP-ja do t'i ndjekë standardet ndërkombëtare për paraqitjen e të dhënave të këtilla. Konkretisht, të gjithë treguesit kryesorë statistikorë do të paraqiten me gabimet standarde përkatëse ose intervalet e besimit, me çka do të mundësohen krahasime të rëndësishme.

Me qëllim që të rritet ndikimi pozitiv i testimit shtetëror në publik, do të vendoset një fushatë gjithëpërfshirëse për raportim dhe shpërndarje (diseminim) për çdo cikël të testimit shtetëror. Kjo do t'i përfshijë të gjitha palët e përfshira: krijuesit e politikave arsimore, komunitetin profesional dhe publikun e gjerë. Qëllimi elementar i informimit të tillë gjithëpërfshirës është të sigurojë informacione që do të përdoren për përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të arsimit dhe, veçanërisht, për të përmirësuar arritjet e gjeneratave të ardhshme.

Me qëllim që të përmbushen nevojat e subjekteve të ndryshme të interesuar, raportimi do të përfshijë një numër të madh aktivitesh, duke përfshirë: publikimin e llojeve të ndryshme të raporteve (në varësi të qëllimit); takime profesionale e publike dhe tribuna; trajnime lidhur me testimin dhe ndarjen e resurseve të fituara nga testimi shtetëror.

9.1. RAPORTET

Gjatë përgatitjes së raporteve të testimit shtetëror për publikun kyç, theks i veçantë do të vihet në formën e tyre që të mundësohet qasje në rezultatet në gjuhën përkatëse të grupit qëllimor dhe të përmbajë elemente që do t'i mundësojnë grupit qëllimor veprim të mëtijshëm, në përputhje me gjetjet. Pas përfundimit të çdo testimi kryesor, do të hartohen:

- raporti i detajuar për arritjet e nxënësve, i destinuar për publikun profesional;
- raporti i shkurtër për gjetjet kryesore, i destinuar për publikun e gjerë;
- raporte plotësuese mbi aspekte specifike të testimit, të destinuara për mësuesit dhe / ose hartuesit e politikave arsimore;
- posterë dhe broshura për gjetjet kryesore, si pjesë e fushatës për marrëdhënie me publikun;
- raporte elektronike për shkollat e përfshira në gjedhe, në mënyrë që t'i ndihmojnë ata në vetëvlerësim (vetevalvim).

Publiku i gjerë do të informohet rregullisht dhe në kohë për qëllimet e testimit shtetëror dhe të gjitha fazat e rëndësishme gjatë realizimit, përmes mediave tradicionale dhe të reja, në mënyrë që të krijojë një qëndrim pozitiv ndaj testimit dhe të shmangë spekulimet dhe keqinterpretimet.

9.2. TRIBUNA

Debatet publike me individë dhe institucione sferë interesi i të cilëve është arsimi (ekspertë vendas dhe të huaj, praktikues, përfaqësues të sektorit joqeveritar, përfaqësues të organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare, shoqata të nxënësve, etj.) do të ofrojnë pikëpamje për anët e mira si dhe anët e këqija të procesit të testimit shtetëror dhe të rezultateve. Qëndrimet dhe propozimet e paraqitura në tribuna do të përdoren për të përmirësuar konceptin e testimit shtetëror, për të përmirësuar procedurat, si dhe për të marrë masa në kuadër të procesit mësimor për të përmirësuar arritjet.

9.3. TRAJNIME

Trajnimet lidhur me realizimin e testimit shtetëror si dhe interpretimin dhe aplikimin e saktë të rezultateve do të zhvillohen në disa faza, me rritje të vazhdueshme të numrit të pjesëmarrësve.

- Trajnimin e mësuesve të shkollave fillore nga ana e QSHP-së, pa marrë parasysh nëse shkollat e tyre janë të përfshira në gjedhen për testim, që të njihen me: qëllimet e matjes së arritjeve të nxënësve në nivel shtetëror; llojin e detyrave që do të përdoren gjatë testimit, procesin e krijimit dhe përdorimit të detyrave të standardizuara për të përmirësuar procesin e mësimin dhe nxënies në paralelet e tyre.
- Trajnime për grupet e punës për përgatitjen e detyrave për para-testim, nga ana e QSHP-së,

para përdorimit të tyre në testimin shtetëror. Po ashtu, janë të parapara trajnime për personat që do të përfshihen në vlerësimin/kodimin e përgjigjeve të nxënësve të dhëna në detyrat e llojit të hapur.

- Trajnime për punonjësit në QSHP dhe persona të tjerë, nga ekspertë të njohur, për analiza primare dhe sekondare të të dhënave nga testimi shtetëror si dhe interpretimi i tyre. Po ashtu, janë paraparë trajnime të specializuara nga ekspertë të huaj, për punonjësit e QSHP-së, për përdorimin e Teorisë për përgjigje në ajtem (IRT), në mënyrë që rezultatet e testimit shtetëror të paraqiten në shkallë teknike valide, të standardizuara.

9.4. QASJE ELEKTRONIKE TEK REZULTATET

QSHP-ja do të krijojë dhe mirëmbajë një uebportal që t'u mundësojë qasje në raportet relevante të testimit shtetëror dhe burime të tjera të ngjashme të praktikuesve të interesuar të arsimin, profesionistëve të MASH-it dhe përgjithësisht publikut të gjerë.

- Publiku i gjerë do të ketë qasje në të gjitha raportet e përgatitura nga QSHP-ja për rezultatet e testimit dhe gjetjet në nivel shtetëror.
- Profesionistët nga fusha e arsimin, përfshirë studentët dhe specialistët të punësuar në institucione shkencore dhe/ose organizata joqeveritare, do të kenë mundësi të paraqesin një kërkesë në QSHP, për qasje në të dhëna

anonime nga testimi shtetëror për analiza të mëtejshme më të hollësishme. Rregullat dhe udhëzimet për mbrojtjen dhe përdorimin e të dhënave do të përgatiten nga QSHP-ja në bashkëpunim me MASH-in.

- Drejtorët e shkollave do të kenë qasje pranë rezultateve të nxënësve nga shkollat e tyre (por jo edhe tek rezultatet e ndonjë shkolle tjetër) për t'u mundësuar atyre të vlerësojnë rezultatet e tyre dhe t'i planifikojnë aktivitetet e brendshme (interne) shkollore me qëllim të përmirësimit të arritjeve të nxënësve.

9.5. MATERIALE PROFESIONALE PËR MËSUESIT


QSHP-ja do të përgatisë përmbledhje të detyrave të përzgjedhura ("ajtime të liruara") të cilat janë përdorur në ciklet e mëparshme të testimit shtetëror, së bashku me udhëzimet e vlerësimit dhe informacione mbi arritjet tipike të nxënësve. Këto përmbledhje, mësuesit do të mund t'i përdorin në mësimin e rregullt. Po ashtu, ato në mënyrë indirekte do tu ndihmojnë mësuesve në përmirësimin e aftësive të tyre për hartimin e test-detyrave sa më cilësore.

Këshilltarët e QSHP-së, në bashkëpunim me ekspertë të tjerë (këshilltarët e BZHA dhe mësuesit), do të përgatisin manuale për mësuesit me qëllim që të përmirësojnë aspektet e ndryshme të mësimdhënies, bazuar në përvojat e testimit shtetëror. Manualët do të miratohen nga MASH.

9.6. "BANKA ELEKTRONIKE E AJTEMËVE"

Pas vendosjes së plotë të sistemit të testimit shtetëror, QSHP-ja do të krijojë një "bankë" elektronike të detyrave (ajtime) për vlerësim të cilën do të përdorin mësuesit e shkollave fillore. Në të do të përfshihen gjithashtu edhe ajtime nga mësuesit që janë trajnuar nga QSHP-ja për hartimin e detyrave. Banka e detyrave (ajtimeve) do tu shërbejë mësuesve si një vegël për bashkëpunim të ndërsjellë me njëri-tjetrin dhe të ndihmojë në hartimin e testeve të standardizuara e cilësore dhe/ose kombinimin e detyrave të standardizuara që do të përdorin në paralelet e tyre. Mësuesit e shkollave fillore do të kenë qasje të lirë për të përdorur bankën e ajtimeve.

Pjesëmarrja e mësuesve në pasurimin e bankës së detyrave do të jetë vullnetare. Këtë aktivitet, së bashku me trajnimin e ofruar nga QSHP-ja, mësuesit do të jenë në gjendje ta përdorin si pjesë të zhvillimit të tyre të vazhdueshëm profesional.



10 PËRGJEGJËSIA INSTITUCIONALE

10.1. MINISTERIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Ministria e Arsimit ka përgjegjësinë përfundimtare për cilësinë e arsimit në shkolla. Prandaj, ajo ka një përgjegjësi edhe në sigurimin e kushteve për realizimin e testimit shtetëror i cili do të shërbejë si "vegël" e rëndësishme për marrjen e informacioneve mbi efektivitetin e arsimit fillor në RMV. Kjo është në përputhshmëri me Ligjin për arsimin fillor, sipas të cilit ministri i arsimit dhe shkencës miraton *Konceptin për testimin shtetëror*, me propozim të Qendrës Shtetërore të Provimeve.

Pasi të bëhet testimi shtetëror plotësisht funksional, MASH do të mbajë përgjegjësinë për vlerësimin e përfitimeve që dalin nga ky testim, si dhe, të formësojë zhvillimin e ardhshëm.

10.2. QENDRA SHTETËRORE E PROVIMEVE

Qendra Shtetërore e Provimeve është një institucion i pavarur përgjegjës për organizimin, realizimin dhe mbështetjen e vlerësimeve të jashtme (eksterne) dhe matjen e arritjeve të nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm në RMV. QSHP-ja ka kapacitet dhe përvojën e duhur për organizimin e provimeve, studimeve ndërkombëtare dhe teste shtetërore të bazuara në gjedhe. Konform kësaj, Ligji për arsimin fillor parashikon që QSHP-ja duhet të jetë institucioni kryesor për realizimin e testimit shtetëror dhe analizën e rezultateve nga ky testim.

QSHP-ja do të përgatisë dhe dokumentojë Procedurat formale për testimin shtetëror, në të cilat do të detajohen të gjitha fazat dhe përgjegjësitë e subjekteve të përfshira, me qëllim që të sigurohet realizim cilësor dhe në kohë. Procedurat do të bazohen në *Konceptin* e miratuar nga ministri i arsimit dhe shkencës.

Përgatitja e testeve dhe pyetësorëve do të koordinohet nga QSHP, ndërsa në grupet e punës për përgatitje do të përfshihen këshilltarët e QSHP-së, mësuesit e shkollave fillore dhe profesorë universitar.

QSHP-ja do të jetë përgjegjëse për përgatitjen e raporteve të rezultateve të testimit shtetëror për palët kyçe të përfshira.

10.3. SHKOLLAT FILLORE PUBLIKE

Bashkëpunimi me drejtorët dhe mësuesit e shkollave fillore publike do të jetë një element thelbësor në realizimin e testimit shtetëror.

QSHP-ja do të emërojë një numër të madh të mësuesve të punësuar në shkollat fillore për të marrë pjesë në zhvillimin e kornizave të vlerësimit dhe përgatitjen e testeve. Kjo do të bëjë të mundur që testimi shtetëror të jetë i përshtatshëm për grupin qëllimor dhe të pasqyrojë praktikën e mirë mësimore.

Në shkollat e përzgjedhura, drejtorët dhe ekipet e tyre për mbështetje do të jenë përgjegjës për realizimin e procesit të mbledhjes së të dhënave. Ekipet shkollore do të sigurojnë që administrimi i testeve dhe pyetësorëve të jetë në përputhshmëri me udhëzimet për procedurat përkatëse.

Të gjitha shkollat fillore publike, të përfshira apo jo në gjedhen për testimin shtetëror, do të jenë përgjegjëse për evalvimin e praktikave vetanake në mësim dhe nxënie në raport me gjetjet kryesore të testimit shtetëror. Aty ku është adekuate dhe e nevojshme, shkollat do të bëjnë ndryshime për të përmirësuar arritjet e nxënësve të tyre.

11 KORNIZA KOHORE PËR IMPLEMENTIM

Ky Koncept, përfundimisht, parashikon krijimin e një testimi shtetëror të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm, me të cilin do të bëhen matjet dhe do të ndiqen arritjet e nxënësve në shkollat fillore në fazat kryesore, përkatësisht në klasën e tretë, të pestë dhe të nëntë. Për zhvillimin dhe realizimin e plotë të testimit shtetëror do të duhet kohë, kapërcimi i sfidave nga aspekti teknik si dhe sigurimi i burime adekuate.

Qasja në faza, e cila fillon me nxënësit me të vegjël të klasës së tretë, do të japë rezultate tre vjet pas fillimit të testimit shtetëror. Dy vjet më vonë, do të jenë në dispozicion edhe rezultatet për grup moshën tjetër, përkatësisht për klasën e pestë. Sipas kësaj, pesë vjet pas fillimit, testimi shtetëror do t'i sigurojë MASH dhe palëve të tjera të dhëna të sakta elementare për dy grupet qëllimore më të reja.

Në vitin e shtatë pas fillimit, do të jetë në dispozicion grupi i dytë i rezultateve për klasën e tretë. Kjo jo vetëm që do të përditësojë pas-

qyrën e arritjeve të nxënësve, por për herë të parë do të sigurojë gjithashtu edhe një tregues të besueshëm të përparimit në kuadër të sistemit të arsimit fillor.

Në vitin e nëntë pas fillimit, do të jetë në dispozicion grupi i dytë i rezultateve për klasën e pestë, ku do të përfshihen edhe treguesit (indikatorët) për përparimin. Për më tepër, këtë vit do të bëhet testimi i parë shtetëror i nxënësve të klasës së nëntë.


Korniza kohore e propozuar dhe e vërtetuar më lart është padyshim ambicioze, por konsiderohet e arritshme. Është i duhur një cikël prej tre vjetësh për kompletimin e plotë të testimit shtetëror për çdo klasë qëllimore, por ciklet mund edhe pjesërisht të përputhen por pa u tejkaluar resurset e QSHP-së dhe pa bërë një barrë të paarsyeshme për shkollat.



TESTIM
SHTETËROR

12 PËRFUNDIME

- Testimi shtetëror i përshkruar në këtë Koncept do t'i sigurojë MASH dhe palëve të tjera të përfshira një pasqyrë të besueshme për të arriturat e nxënësve gjatë arsimit fillor, e cila është me rëndësi jetike.
- Analiza e faktorëve që ndikojnë ndaj rezultateve nga të nxënit, do t'u sigurojë, krijuesve të politikave arsimore dhe praktikantëve, prova (dëshmi) objektive lidhur me atë që funksionon mirë në shkollat fillore dhe çfarë nuk funksionon. Provat e tilla kanë potencialin për të identifikuar politikat efektive dhe për të përmirësuar praktikat në mësim dhe nxënie.
- Me kalimin e kohës, testimi shtetëror do të gjenerojë tregues të besueshëm të përparimit të cilët mund të përdoren për evalvimin sistematik të efikasitetit të sistemit dhe për çfarëdo ndërhyrje strategjike.
- Testimi shtetëror do të sigurojë të dhëna që janë të rëndësishme për kontekstin ekzistues në shkollat fillore në RMV. Ata do të plotësojnë të dhënat e mbledhura përmes pjesëmarrjes së shtetit në studimet ndërkombëtare për matjen e arritjeve të nxënësve.
- Realizimi i këtij testimi shtetëror do të kompletojë kornizën shtetërore për vlerësimin në arsim, përkatësisht do të vendosen të katër elementet që rekomandohen për menaxhimin efektiv të sistemit: vlerësimi në klasë; provime; vlerësime ndërkombëtare dhe teste shtetërore (vlerësime nacionale).



SHTOJCA

PROGRAMI (ORARI) PËR REALIZIMIN E TESTIMIT SHTETËROR PËR ARSIMIN FILLOR

Viti i realizimit	Viti kalendarik	Klasa (Gjenerata e nxënësve)	Llojet e testimit	Llojet e raporteve
1	2021	III (Gj. 1)	Para-testimi	Raporte interne**
2	2022	III (Gj. 2)	Testimi Kryesor	
3	2023	V (Gj. 1)	Para-testimi	Raporti kryesor (III - Gj. 2)* Raporte interne**
4	2024	V (Gj. 2)	Testimi Kryesor	
5	2025	III (Gj. 5)	Para-testimi	Raporti kryesor (V - Gj. 2)* Raporte interne**
6	2026	III (Gj. 6)	Testimi Kryesor	Raporte krahasimtare:*** - Gj.2 (në klasën V dhe në klasën III)
7	2027	V (Gj. 5) IX (Gj. 1)	Para-testimi Para-testimi	Raporti kryesor (III - Gj. 6)* Raporte interne**
8	2028	V (Gj. 6) IX (Gj. 2)	Testimi Kryesor Testimi Kryesor	Raporte krahasimtare:*** - klasa III (Gj. 6 me Gj. 2)
9	2029	III (Gj. 9)	Para-testimi	Raporti kryesor (V - Gj. 6)* Raporti kryesor (IX - Gj. 2)* Raporte interne**
10	2030	III (Gj. 10)	Testimi Kryesor	Raporte krahasimtare:*** - klasa V. (Gj. 6 me Gj. 2) - Gj. 2 (në klasën IX, V dhe III) - Gj. 6 (në klasën V dhe në klasën III)
11	2031	V (Gj. 9) IX (Gj. 5)	Para-testimi Para-testimi	Raporti kryesor (III - Gj. 10)* Raporte interne**
12	2032	V (Gj. 10) IX (Gj. 6)	Testimi Kryesor Testimi Kryesor	Raporte krahasimtare:*** - klasa III. (Gj. 10 me Gj. 6 me Gj. 2)
13	2033	III (Gj. 13)	Para-testimi	Raporti kryesor (V - Gj. 10)* Raporti kryesor (IX - Gj. 6)* Raporte interne**
14	2034	III (Gj. 14)	Testimi Kryesor	Raporte krahasimtare:*** - klasa V. (Gj. 10 me Gj. 6 me Gj. 2) - klasa IX. (Gj. 6 me Gj. 2) - Gj. 6 (në klasën IX, V dhe III) - Gj. 10 (në klasën V dhe në klasën III)
15	2035	V (Gj. 13) IX (Gj. 9)	Para-testimi Para-testimi	Raporti kryesor (III - Gj. 14)* Raporte interne**

SHËNIME PËR PROGRAMI (ORARI):

1. Llojet e testimit:

- Arritjet e nxënësve nga klasa III, V dhe IX testohen me cikle tre vjeçare (para-testimi, testimi kryesor dhe raporti) që fillojnë çdo vit të katërt. Për shkak të përputhjes së cikleve të ndryshme, testimet (para-testimi ose testimi kryesor) organizohen çdo vit.
- Arritjet e nxënësve nga klasa V dhe IX, duke filluar me ciklin në vitin 2027, testohen në të njëjtin vit.

2. Llojet e raporteve:

- * Raporti kryesor përgatitet gjithmonë në vitin e parë pas testimit kryesor, përkatësisht në vitin e tretë të ciklit tre-vjeçar.
- ** Raportet e brendshme përgatiten menjëherë pas çdo para-testimi, deri në fund të të njëjtit vit kalendarik (në vitin e parë të ciklit tre vjeçar). Llojet e raporteve të brendshme-interne:
 - Raport teknik për kryerjen e testimit dhe verifikimin e procedurave (për nevojat e QSHP).
 - Raport për cilësinë e detyrave (për nevojat e grupeve punuese të lëndës përkatëse).
- *** Raportet krahasuese përgatiten në vitin e dytë pas testimit kryesor, përkatësisht pas përfundimit të ciklit tre vjeçar. Llojet e raporteve krahasimtare:
 - Raporte krahasimtare për arritjet e nxënësve të gjeneratave të ndryshme në të njëjtën klasë (p.sh., krahasimi i arritjeve në klasën III të nxënësve të testuar të gjeneratës së dytë – Gj. 2 me arritjet e nxënësve të gjeneratës së gjashtë – Gj.6 dhe me arritjet e nxënësve të gjeneratës së dhjetë – Gj. 10).
 - Raporte krahasimtare për arritjet e të njëjtës gjeneratë nxënësish por në klasa të ndryshme (p.sh., arritjet e nxënësve të gjeneratës së dytë – Gj. 2, testuar në klasën III, V dhe IX).

3. Lëndë mësimore:

Në program nuk janë cekur lëndët mësimore sepse për to janë dhënë informacione të detajuara në kapitujt e mëparshëm të dokumentit. Por është e rëndësishme të theksohet se:

- Çdo vit (në para-testimet dhe testimet kryesore) testohen arritjet e nxënësve në gjuhën e tyre amtare (në gjuhën mësimore maqedonase dhe në gjuhën mësimore shqipe) dhe në matematikë (në gjuhën mësimore maqedonase dhe në gjuhën mësimore shqipe).
- Testimi i arritjeve në gjuhën amtare në klasën V, për nxënësit që ndjekin mësim në gjuhën mësimore turke, gjuhën mësimore serbe ose gjuhën mësimore boshnjake do të bëhet atëherë kur do të silllet një vendim i veçantë nga ministri i arsimit dhe shkencës.
- Lënda e tretë mësimore dhe viti kur do të bëhet realizimi i testimit për këtë lëndë përcaktohen me vendim të veçantë të ministrit të arsimit dhe shkencës. Lënda e tretë mësimore mund të jetë e ndryshme në secilin testim dhe / ose të jetë ndërdisiplinor.

Programi i propozuar përfshin një periudhë prej 15 vitesh kalendarike. Katër vitet e para kalendarike të testimit shtetëror konsiderohen një periudhë për stabilizimin e procedurave për organizimin e testimit dhe krijimin e materialeve cilësore për provime.



Botuesi:
Qendra Shtetërore e Provimeve
rr. „Vasill Gjorgjov“, pn, Shkup



Për botuesin:
Llidiya Gjoshevska, drejtor në QShP



Billjana Mihajllavska, Beti Llameva

KONCEPTI PËR TESTIM SHTETËROR NË ARSIMIN FILLOR



Përktheu në gjuhën shqipe:
Afërdita Saraçini



Projektimi grafik:
Billjana Mihajllavska



Tirazhi:



Shtëpia botuese:



TESTIM
SHTETËROR

